

VENDIM
Nr. 164, datë 19.7.2018

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, ME NR. 258, SERIA T14, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 133, DATË 24.12.2014

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13 dhe 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për pranimin e kërkesës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për modifikimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 133, datë 24.12.2014, ka licencuar shoqërinë “Le Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar dhe subjekti posedon licencën me nr. 258, seria T14.

- Shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 400 prot., datë 17.5.2018, ka bërë me dije se shoqëria “Le Trading Albania” sh.p.k. ka ndryshuar emrin e subjektit dhe atë tregtar, si më poshtë:

Emri i ri i subjektit bëhet “Energia Gas and Power Albania”.

Emri i ri tregtar bëhet “Energia Gas and Power Albania”.

- Në vijim të korrespondencës sipërcituar, ERE, me shkresën nr. 400/1 prot., datë 25.5.2018, i ka bërë me dije shoqërisë se ndryshimet e bëra emrit të subjektit dhe të reflektuara në QKR, duhet të reflektohen edhe në licencën e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 258, seria T14.

- Si rezultat, shoqëria ka detyrimin, që në zbatim të nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit, rinovimit ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të aplikojë në ERE për modifikimin e licencës.

- Sa më sipër, shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 436 prot. të ERE-s, datë 7.6.2018, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, duke kërkuar ndryshimin e emrit të mbajtësit të saj nga “Le Trading Albania” sh.p.k., në “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k.

- Sa më sipër, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 138, datë 25.6.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për modifikimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, me nr. 258, seria T14, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 55/42 prot., datë 26.6.2018, bëri njoftimin në median e shkruar mbi fillimin e procedurës për këtë modifikim, si dhe me shkresën nr. 436/1 prot., datë 5.7.2018, bëri me dije subjektin për fillimin e procedurës dhe iu kërkuar të depozitojë dokumentacionin e munguar.

- Subjekti “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 436/4 prot., datë 10.7.2018, ka përcjellë në ERE mungesën e dokumentacionit, e cila konsiston në vendimin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë sipërcituar.

- Aplikimi i shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara

nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1, formati dhe dokumentacioni për aplikim;
- germa “a” (të dhënat për aplikim): plotësuar;
- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesin): plotësuar;
- germa “c” (të dhëna për aplikuesin): plotësuar;
- Neni 8, pika 2:

Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin A të kësaj rregulloreje, në shumën 30 000 lekë: plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “a”: informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa c: miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjerë të licencës, kur këta janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Nuk aplikohet në këtë rast kjo kërkesë e rregullores, pasi nga subjekti kërkohet vetëm ndryshimi i emrit.

- Neni 15, pika 4, germa d: ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit. Modifikimi që po kryhet nuk prek detyrimet e të licencuarit sa i përket mbarëvajtjes së punës për llojin e aktivitetit.

- Neni 15, pika 4, germa “e”, të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për modifikimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 258, seria T14, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014.

2. Në titull dhe përmbajtje të licencës nr. 258, seria T14, emërtimi “Le Trading Albania” sh.p.k., do të zëvendësohet me emërtimin “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti